



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/03-12215 dt. 17.03. 2022

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **24.03.2022**, (E Enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS


Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i KK i mbajtur me dt. 23.02.2022, dhe Procesverbali i mbledhjes së Jashtzakonshme i KK i mbajtur me dt. 08.03.2022.
2. Raporti i punës Janar-Dhjetor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
3. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020.
4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për mallërat dhe shërbimet në buxhetin e drejtoratit për shërbimet publike dhe emergjente për projektet: mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike dhe rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara.
5. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për Mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtoris për infrastruktur publike.
6. Të ndryshme.

Drenas, 17.03.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Dated		17.03	2022
Nj. Org	Numër	Shërbim	Vlera
02-052/09-12217			



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 17.03.2022, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës, ku i njoftoi se kemi edhe një pikë shtesë : 1. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për Mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtorisë për inëfrastrukturë publike.

Sa për sqarim ja dha fjalën drejtorit Shyqiri Bublaku, pastaj i pyeti të pranishmit nëse ka dikush debat rreth pikave të rendit të ditës mundet me marr fjalën, diskutime nuk pati hedhi në votim rendin e ditës.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 16.02.2022.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

2. Raporti i punës Janar-Dhjetor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.

-Rekomandohet për Kuvend

3. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020.

-Rekomandohet për Kuvend

4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për mallërat dhe shërbimet në buxhetin e drejtoratit për shërbimet publike dhe emergjente për projektet: mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike dhe rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

5. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për Mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtorisë për inëfrastrukturë publike.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

6. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për Mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtorisë për inëfrastrukturë publike.

- Votuan 06 Për, Kundër: 00, dhe Abstenim: 00

7. Të ndryshme.

Pasi përfunduan diskutimet mbledhja përfundoi në ora 11: 30.



Kryesuesi i Kuvendit

Milutin Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-MM00 dt. 10.03.2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **23.02.2022**
Me gjerësisht, mbledhja e dytë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.01.2022.
2. Propozim Vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022.
3. Propozim Vendim për shfuqizimin e pikës 13, të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569, të dt. 29.11. 2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit social.
5. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 12-462/01-4122, të dt. 26.01.2022.
6. Të ndryshme.



Mbahet mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Komuna e Drenasit, ku për diskutim ishin 6 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale dhe anëtarë të Kuvendit, si dhe 28 anetar të kuvendit Komunal.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: **28 vota (Për)**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.01.2022.**

Pasi nuk pati diskutime, Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal i datës 26.01.2022 ka kaluar me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022.**

Arbër Halilaj- meqë e kemi diskutuar në KPF sipas drejtoreshës do të behet një plan unik për menaxhimin e mbeturinave ne kuadër të të gjitha komunave, mirëpo duke pas parasysh se secila komunë ka qeshjet dhe specifikat e veta si dhe duke u bazuar në atë se në komunën tonë ka një keq menaxhim të mbeturinave nga kompania rajonale "Pastrimi" e cila e ofron këtë shërbim dhe i faturohet shërbimi i qytetareve dhe nuk marrin shërbim e cilësor, duke u bazuar në këtë propozoj subjekteve opozitare të abstenojmë me çështjen e vazhdimit të vlefshmërisë të planit ekzistues, duke përkrahur ankesat e qytetareve që nuk e marrin këtë shërbim.

Azemine Bujupi-Gjoka, në emër të grupi parlamentar të DD jemi të pajtimit për të vazhduar plani aktual i menaxhimit të mbeturinave pasi që ky plan edhe është unik për komunat e Kosovës, mirëpo këtu jemi për të paraqitur shqetësimet e qytetareve ndaj kompanisë "Pastrimi" për pastrimin e mbeturinave si e përgjegjeshme ndaj qytetareve të Drenasit të cilët rregullisht paguajnë taksën për mbeturina dhe pse nuk kryhen shërbimet nga kontaktori i pastrimit, përgjegjësia mbetet nga kompania e lartpërmendur por duke mos e lënë pas edhe qeverinë komunale e cila nuk ka hartuar ndonjë plan veprimi për këtë çështje me rendësi, pasi që mbeturinat e grumbulluara janë berivatra të infeksionit për qytetaret e Drenasit dhe sigurisht kjo çështje i takon qeverisë lokale por për çdo problem tjetër edhe për këtë gjë kaq serioze dhe delikate ka zgjedhur heshtjen dhe mosveprimin.

Ne kërkojmë për qytetaret e Drenasit të lirohen nga pagesa e faturimit për mbeturina për muajin janar dhe shkurt, me anë të kësaj kërkesë adresohemi kompanisë rajonale "Pastrimi"

Drin Halilaj, edhe unë e pata të njëjtin shqetësim lidhur me mbledhjen e mbeturinave nga kompania "Pastrimi" a ka ndërmarrë diçka komuna ndaj operatorit në fjalë?

Drejtoresha për shërbime publike dhe Emergjence, Lumnije Krapi-Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM) i Komunës së Glllogocit është dokument i hartuar në bazë të Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave të Republikës së Kosovës dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbeturinave në Republikën e Kosovës.

Objektivat dhe aktivitetet vjetore të planifikuara dhe realizuara në këtë plan raportohen në AMMK (Agjensionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës) dhe në MAPL, dhe janë mjaft të rëndësishme për Grantin "Mjedisi i Pastër" dhe atë të "Përformancës komunale", të cilat vlerësojnë dhe shpërblejnë të arriturat e komunave në fushën e menaxhimit të mbeturinave, ku komuna nga këto grande vetëm në vitin e kaluar ka fituar mbi milion euro.

Bazuar në planin aktual të menaxhimit të mbeturinave gjatë vitit kalendarik 2021 janë realizuar aktivitete lidhur me përmbushjen e objektivave të planifikuara, por edhe gjatë këtij viti objektivat në planin aktual janë të rëndësishme që të realizohen përmes aktiviteteve, andaj kërkojmë që ky plan të jetë i vlefshëm për raportim edhe për vitin kalendarik 2022, deri sa të bëhet hartimi i Planit të ri.

Si objektivi i Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – GIZ, suporton komunat, përkatësisht grupin punues për hartimin e planit të menaxhimit të komunat përmes ofrimit të trajnimit mbi planifikimin strategjik i cili fuqizoi kapacitetet e stafit lokal për të hartuar dhe për të monitoruar PMM, përfshirë plane veprimi, organizative dhe financiare.

Çdo vit kalendarik komunat e kanë obligative të raportojnë rreth fushës së menaxhimit të mbeturinave në përgjithësi në Ministrinë e Planifikimit dhe Mjedisit në koordinim me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – GIZ, Në këtë raport pasqyrohet gjendja e zbatimit të legjislacionit në fushën e menaxhimit të mbeturinave komunale, mbulimit me shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave, faturimin dhe arkëtimin, identifikimin dhe regjistrimin e deponive ilegale në tërë territorin e vendit, sasinë e mbeturinave komunale të grumbulluar dhe të gjeneruar sipas komunave. Dita e fundit e raportimit është data 31 Mars, dhe njeri prej indikatorëve që duhet plotësuar është që komuna të ketë planin e menaxhimit të mbeturinave validitet. Bazuar në Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave, Neni 10, neni, pika 5 e paragrafit 1 dhe 2, mundet të revidohet sipas nevojës. Andaj si DSHPE- kërkojmë që ky plan të jetë i vlefshëm për vitin 2022.

Labinot Halilaj, sa i përket menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Drenasit për katër vjet qeverisje ka fituar me se shumti grande në këtë drejtim, duhet të mbeshtetet ky plan për vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022.

Valentina Leku, ne jemi për me e mbështet, por ne e kemi një kontratë individuale secili me kompaninë e pastrimit dhe të dy palët duhet me ju përmbajt kontratës dhe nëse ne nuk e paguajmë ose nuk ju përmbahemi kontratës kalon vlerën mbi 50 € atëherë na dërgojnë në përmbarues, dhe njëjte edhe ata nuk po ju përmbahen kontratës sepse nuk po e kryejnë shërbimin me rregull, dhe ky shërbim jo i rregullt është shqetësim i madh për të gjithë qytetaret, çka duhet bërë ju në këtë rast?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- çështja e kontratave me kompaninë e pastrimit dhe qytetaret nuk ka të bëjë me qeverisje komunale dhe me komunën sepse janë të lidhura me kompaninë rajonale ku janë 8 komuna. Ne si komunë kemi bërë çdo gjë që është e mundshme që t'i krijojmë kësaj kompanie kushte për punë, si rezultat i kësaj ne vetëm këtë vit kemi sjellë një grand prej 546 mijë euro si rezultat i performancës të mirë, këto mjete nuk mund ne t'i shfrytëzojmë ne po i dedikohen kompanisë ku kompania blen makineri të kryerjes sa ma të mirë të shërbimit të qytetareve. Çdo ankesë të qytetareve që vijnë ne i adresojmë te kompania në nivel qendror, e i ngitem shqetësimet tona çdo herë, e vetmja gjë që mund ta bëjmë është ta ndërrojmë statutin e komunës dhe të kërkojmë që ta kemi kompaninë të jetë kompani komunale, ne nuk mund me zhvillu procedura tjera sepse nuk na lejohet.

Arbër Halilaj, në plaprogramin e GREEN për Drenasin përveç formimit të një drejtorie të veçantë për çështje mjedisore, kjo është e publikuar në shtator të vitit 2021 ne piken e dytë ceket si zgjidhja më e mirë në këtë aspekt formimi i kompanisë publike lokale e cila do t'i jepte përgjegjësi këtij kuvendi komunal dhe drejtorisë përkatëse me qëllim të decentralizimit, rritjes së efikasitetit dhe kryerjes të shumë shërbimeve komunale, menaxhimit e grumbullimit të mbeturinave në Komunën e Drenasit, dhe rregullimin e mbeturinave mirëmbajtjen e pastërtisë të të gjitha shesheve dhe parqeve publike, hapësirave tjera gjelbëruese, varrezat, pastërtisë të rrugëve etj. Po ashtu të shqyrtohet ndarja e mbeturinave në bazë dhe reciklimi i tyre meqë ka filluar si pilotprojekt, me mundësi të rritjes së punëtorëve dhe përfitimit ekonomik të kompanisë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- kur të jeni gati e ndërrojmë statutin e komunës, edhe drejtorinë e shtojmë mirëpo duhet me e ndërruar rregulloren e komunës këtë vit për me mujt me nda buxhetin dhe me kriju drejtorinë vitin e ardhshëm, unë nuk jam kundër jam për, çdo program i mirë që e ka ne jemi të gatshëm me implementu.

Mehedin Salihu, ne të gjithë po e shohim që kompania nuk është duke i kryer shërbimet si duhet.

Hamit Haxhiu, unë kam kërkuar edhe në KPF-ca që drejtoresha ta bëjë kërkesën tek Ministria e Planifikimit Hapësinor që taksapaguesit me i liru nga pagesa për muajin janar dhe shkurt.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- qeveria nuk bën selektim të komunave një komunë me i heq pagesat dhe një jo.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim propozim vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: **28 vota (Për), 0 votë (Kundër), 0 vota (Abstenim).**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për shfuqizimin e pikës 13, të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569, të dt. 29.11. 2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.**

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, kjo pikë ka të bëjë me shfrytëzimit e banesës të përkohshme social, është një kërkesë e një shfrytëzuesi e cila e ka bërë zgjidhjen e banimit dhe e liron banesën, në mënyrë që të përgatitet për shpalljen e ardhshme, banesa kalon në menaxhimin e drejtorisë derisa të bëhet shpallja dhe t'i ipet dikujt në shfrytëzim.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: **24 vota (Për), 0 votë (Kundër), 4 vota (Abstenim).**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit social.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- propozoj që komisioni të formohet me tre anëtar nga Kuvendi, 3 anëtar nga ekzekutivi, 1 anëtar nga shoqëria civile.

Bekim Lestrani- grupi kuvendar i PDK-së propozon për anëtar të komisionit - *Albulena Saliuku.*

Azemine Bujupi-Gjoka, Grupi parlamentar DD e propozon për anëtar të komisionit – *Jahir Hajdari.*

Egzona Tërdevci- Grupi i asambleistëve LL propozon për anëtar të komisionit- *Florentina Elezi-Veliu.*

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu-Nga ekzekutivi propozon për anëtar të komisionit *Lumturije Kiqina, Jeton Prokshi, Besart Bajrami, Jetmire Morina nga shoqëria Civile.*

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit me përbërje të këtij komisioni: **Albulena Saliuku- anëtare nga kuvendi**

Jahir Hajdari - anëtar nga kuvendi

Florentina Elezi-Veliu- anëtare nga kuvendi

Lumturije Kiqina- anëtar nga ekzekutivi

Jeton Prokshi - anëtar nga ekzekutivi

Besart Bajram- anëtar nga ekzekutivi

Jetmire Morina - anëtar nga shoqëria Civile.

Prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar dhe votuan me: **28 vota (Për), 0 votë (Kundër), 0 vota (Abstenim).**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 12-462/01-4122, të dt. 26.01.2022.**

Egzona Tërdevci-vendimet e Kuvendit Komunal nuk janë duke u publikuar ne ueb faqe e komunës, i kam shikuar vendimet e vitit 2022 asnjë vendim nuk është i publikuar, mendoj se kjo e rrit transparencën komunale.

Azemine Bujupi-Gjoka, kujt po i shkon për shtati ky hap i ngutshëm për formimin e komisionit të dt. 26.01.2022, pa u konsultuar paraprakisht me ministrinë e planifikimit hapësinor për pronat të cilat keni me i dhënë në shfrytëzim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci - çdo komunë e formon komisionin për dhënien e pronave në shfrytëzim, për çdo vjet komisionet i kemi formuar në fillim të vitit, ligji ka ndryshuar dhe thotë komisioni formohet pas shpalljes së pronës publike dhe për ato prona që i shpallë, formohet komisioni.

Azemine Bujupi-Gjoka, pse po shfuqizohet ky vendim?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – vendimet kthehen për shfuqizim që nuk marrin ligjshmëri, nuk janë vendime të kundërligjshme, vendimet kthehen nga MAPL-ja kur nuk janë të plotësuar, e shfuqizojmë sepse çdo vendim që merret në kuvend dhe nuk merr ligjshmërinë nga MAPL-ja brenda 30 ditëve duhet me u shfuqizua ai vendim.

Marigona Bazaj, kryetari e ceki që duhet 30 ditë derisa të kthehet përgjigja për një vendim që është marrë, mirëpo ende nuk i ka bërë 30 ditë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ministria vendimet i shqyrton brenda 15 ditëve, një vendim MAPL-ja e dërgon në ministrinë përkatëse mund me ndodh që zgjatë edhe me shumë se një muaj, por na njofton me email. Vendimi duhet me u shfuqizua brenda 30 ditëve nëse na njofton se vendimi nuk është i ligjshëm ne jemi të detyruar brenda 30 ditëve me u shfuqizua.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim, Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 12-462/01-4122, të dt. 26.01.2022, prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar dhe votuan me: *26 vota (Për), 0 votë (Kundër), 0 vota (Abstenim)*.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Të ndryshme.**

Mërgim Pirraku, i kam dy shqetësime për zyrën e kryetarit, lëvizja "Fol" në raportin për shkarkimin e paligjshëm të punëtorëve në sektorin publik e ka paraqit komunën tonë si kampione në dhjetë muajt e fundit për humbjen e 65 rasteve që kanë qenë kontekste gjyqësore për largimin e paligjshëm të punëtorëve në sektorin publik edhe kjo e ka dëmtuar rend buxhetin e komunës kërkoj sqarime lidhur me këtë dhe a do të jap dikush përgjegjësi juridike ata përgjegjës që i kanë larguar këta paligjshëm nga puna. Dhe pyetja dytë: në planifikimin e buxhetit për një vit kalendarik për komunën tonë ende nuk e keni zgjidhë problemin ku punëtorët e rinjë që punësohen në sektorin publik shumica e tyre nuk hyjnë në listën e pagave ndoshta edhe deri në 6 muaj duke ju vonuar pagat e tyre, duhet të zgjidhet ky problem, sepse si shkak i kësaj Komuna e Drenasit ka paguar shumë në kontekste gjyqësore.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- unë nuk e kam shikuar atë raport të lëvizjes "Fol" asnjë shkarkim në sektorin publik komuna nuk e ka bërë, nuk ka ndodh as një masë as një gjyq nuk e kemi humb, ne e bëjmë mirë që planifikimin e buxhetit, çështjen që i ngrite një punëtor kur shkon në pushim pa pagesë apo punëtorë që shkon në pushim të lehonisë edhe e marrin dikën tjetër zëvendësim nuk kanë të drejt me hi ne lista të pagave sepse nuk janë të

përhershëm dhe këto janë procedura tjera dhe janë procedura që nuk i kem bërë ne por i ka bërë niveli qendror dhe nuk bëjmë shkelje.

Egzona Tërdevci, pyeti: kur do të formohet komisioni për emërtim të rrugëve?

Pati një kërkesë: pasi kemi marrë shqetësime nga banoret e asaj zone asamblistët nga grupi ynë kemi dal në teren për ta vizituar lumin "Drenica" përkatësisht pjesën mbrapa varrezave të qytetit, gjendja e lumit me të vërtetë është e keqe sepse aty janë hedhur ujerat e zeza po ashtu, sipas informatave që ne i kemi kompania IP-kos e cila ka marrë pronë nga komuna, përkatësisht kompania KVE e angazhuar nga kompania paraprake, gropën septike jofunksionale prej viteve po e zbraz duke e hedhur përmbajtjen e saj në lumin "Drenica" më shqetësuese është që kompania aludon se leja për këtë hedhje i është dhënë nga komuna, a jeni të vetëdijshëm për shkatërrimi që po i behet lumit pasi kjo gjendje është raportuar edhe ne media pa marrë mundin komuna me dal me inspektoriat në teren. Të pasurit e një ambienti të pasur e të sigurt për vete, për familjen e për fëmijët e tyre është e drejtë qenësore e të gjithë qytetareve tanë, prandaj nëse komuna ka lejuar me ose pa qellim degradimin e ambientit përkatësisht lumit "Drenica" do duhet ta marrë përgjegjësisë edhe për pastrimin e saj.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- komisioni për emërtim të rrugëve formohet nga kuvendi i komunës, kur të jeni të gatshëm e bëjmë komisionin. Sa i përket mbetjeve të ujrave te zeza gropa septike në zonën ku komuna e ka dhënë në shfrytëzim e që përfutës i saj është kompania IP-kos e cila ka ofruar një vlerë të investimit numër të punësimit dhe shumën e qiras për komunën, gropa septike e cila ka qenë në atë zonë është eliminuar sepse pronat duhet të lirohen për me i dhënë në shfrytëzi. Ujerat e zeza jemi komuna e parë në Kosovë që po mundohemi me i larguar nga përroskat dhe lumenjtë si rezultat i kësaj kemi investuar miliona euro për t'i vendos kolektorët përreth lumenjve tanë dhe si rezultat kemi bërë edhe pastrimin e lumenjve ose zgjerimin e shtatit të lumit për qëllimin që me i vendos kolektorët, sa i përket impiantit përpunimit të ujërave të zeza, ne disa herë kemi kërkuar nga qeveria se është një impiant i cili është i kushtueshëm dhe me mjetet që ndahen për investime kapitale nuk ka mundësi me u ndërtuar sepse kushton shumë. Nuk është e vërtetë që kompania në fjalë po i hedh ujerat e zeza në lum sepse kemi dal i kemi konstatuar dhe kompania në fjalë është duke i liruar mbetjet e vjetra. Ne i kemi krijuar kushtet për impiant, qeveria mundet me investua dhe mundet me kontrubu në atë drejtim.

Egzona Tërdevci, gropën septike e ka pastruar komuna para se me e marrë kompania në fjalë pronën dhe prej vizitës në teren ju keni evidentu që kompania mbetjet nuk i ka hedh në lum por i ka bart me cisterna?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- gropën septike nuk e kemi pastruar, e kemi për obligim me e pastu ne, ndërsa kompania po e pastron, nuk i ka hedh në lum, gropa është duke u larguar me anë të cisternave.

Drin Halilaj - një shqetësim që kemi pranuar këto ditë është lidhur me qentë endacak, a ka ndërmarrë diçka komuna lidhur me këtë çështje apo a ka ne plan me u ndërmarrë?

Drejtoresha për shërbime publike dhe emergjence, Lumrije Krapin- sa i përket shqetësimit të ngritur është një shqetësim që vazhdimisht e kemi nga ana e qytetareve është një shqetësim që na shqetëson edhe neve si komunë mirëpo deri në vitin e kaluar ka qenë nen menaxhimin për agresionin për ushqim dhe veterinari ndërsa këtë vit e kemi nënshkruar një marrëveshjen me fondacionin StrayCoco në seli në Zvicerr në bashkëpunim me komunën,

njoftimin e kemi bërë edhe në faqen e komunës, e kemi njoftuar edhe policinë në Drenas, gjithashtu gjitha kërkesat që vijnë ne drejtori i adresojmë në fondacionin StrayCoco.

Azmine Bujupi-Gjoka, në emër të DD-së do të ngriti dy çështje me rendësi për qytetaret e Drenasit: 1. Çështjen e furnizimit me ujë të pijshëm e cila ka mbetë e pazgjidhur për 22 fshatra të Drenasit, disa fshatra në Komunën e Drenasit përdorin ujin e pijshëm nëntokësor mirëpo disa nuk kanë as ujë të pijshëm nëntokësor, shembull konkret i kemi banoret e lagjes Gjoka në Terstenikun II që vetëm 1 km qëndrojnë larg vendit për tu kyçur në rrjetin e ujësjellësit prandaj kërkojmë zgjidhje urgjente sepse është element bazë për jetë, mbetet që drejtori i infrastrukturës z. Endrit Gllareva të paraqes planin e veprimit për zgjedhjen e kësaj çështje jetike për banoret e lagjes Gjoka. Meqë jam biologë me profesion kam të drejtë të flas për mjedisin i cili fatkeqësisht në Drenas ka degraduar nuk ka asnjë projekt të vërtetshëm në këtë drejtim madje është mirë të jemi të informuar edhe për grandin e fituar prej 1 milion euro se ku dhe si do të shpenzohet, deri më tani nuk kemi ndonjë informacion konkret nga drejtoria komunale.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovi- komuna e ka për obligim me i kry investimet për rrjetin e ujësjellësit, niveli qendror e ka obligim me e bërë furnizimin me ujë, kapacitetet e rrjetit duhet t'i krijojmë ne dhe jemi duke e bërë atë gjë, kapacitetin e sjelljes të ujit të pijes janë e ka për obligim niveli qendror, prandaj ne kemi shpall interes të përgjithshëm ndërtimi në liqenit të Verbocit.

Drejtoresha për për shërbime publike dhe emergjence, Lumnije Krapit, Qëllimi dhe objektivi i DSHPE është zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet përvetësimit të praktikave funksionale të menaxhimit të mbeturinave(si për shembull, ndarja e mbeturinave në burim, përmes shportave të veçanta 240l dhe komposter) të cilat do të rezultojnë në një mjedis më të pastër për komunitetet brenda Drenasit.

Ligji për mbeturinat, thekson se komuna duhet të sigurojë infrastrukturën e përshtatshme për menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e kushteve për operim. Komuna çdo vit ka fituar grante, dhe të njëjtat do të jenë si asete komunale, por që i japin kompanisë në shfrytëzim. Në vitin 2017 është blerë një kamion të cilën kompania e ka në shfrytëzim. Në kuadër të mjeteve për garantin mjedisi i pastër për vitin 2018, jemi të njoftuar nga GIZ dhe MMPH që është në procedurë të prokurimit është një kamion për grumbullim të mbeturinave me kapacitet 16 ton. Po ashtu edhe në kuadër të garantëve të tjerë të fituara për vitin 2019 dhe 2020, bazuar në vlerësimin e nevojave kemi kërkuar makineri për menaxhimin e mbeturinave kamion 8m³ dhe kamion transportues me kapacitet 30 m³.

Azmine Bujupi-Gjoka, ju e keni marrë grandin në vitin 2021 ju keni kërkuar që me pas një kamion për menaxhimin e mbeturinave dmth do të zgjidhet problemi, ju do t'i ndihmoni përmes këtij grandit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovi, ne kemi fituar grante për çdo vit, ne i kemi dhënë mjetet në dispozicion të zhvillimit të procedurave i kemi pas 227 mijë afër 160 mijë euro ka kushtuar kamioni, nuk kemi zhvilluar në procedurë Gizi gjerman i zhvillon procedurat, 2021 i kemi fituar 546 mijë euro për vitin 2020 dhe ato mjete janë në dispozicion të Gizit gjerman ne i tregojmë se çka po kërkojmë dhe ata i zhvillojnë vet procedurat. Mjetet që janë shpenzuar janë shpenzuar ndërsa të tjerat çka mbesin i bashkëngjiten grandin tjetër dhe nuk humbin mjetet po vetëm rritet vlera.

Mehedin Salihu- hapësira para QKMF-së edhe parkingu i cili është gjithmonë i sterngarkuar aty edhe ambulanca kur ka ndonjë rast nuk mundet me kalu se plot qytetar i lënë veturat, është dasht me qenë një punëtor sigurimi. Dhe shqetësimi tjetër është për ambulanten në Komoran kjo ambulante frekuentohet me pacient nga shumë komuna tjera sidomos nga Shala, Lipjani, Malisheva nuk a kam fjalën për raste urgjente por për raste te ftohta, sipas informatave që i kena edhe atje punojnë deri në ora 20:00 por edhe ata e kanë më të lehtë apo me afër dhe shërbimin e kryejnë tek ne. Për drejtorin e arsimit e kam një pyetje ne konkursin e shpallur me dt. 14 janar në shkollën profesionale "Fehmi Lladrovci" është lënë anash një mësimdhënës është kërkuar mësimdhënësi makinerisë është lënë anash një inxhinier me 10 vjet pune që ka punuar aty dhe është marrë një tjetër person.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket parkimit të QKMF-së gjitha ato objekte afër që janë e që kanë qasje direkte në oborrin e QKMF-së e kanë të padrejtë qasjen dhe shumica prej tyre i parkojnë automjetet e tyre aty edhe kur ka qenë sigurimi fizik ka qenë e njëjta situatë. Do ta bëjmë QKMF-në e re dhe ne kuadër të kësaj do ta bëjmë edhe rrethojën e gjithë pronës të QKMF-së që do ta ketë vetëm një hyrje me pagese. QMF-ja në Komoran nuk jep shërbime qytetareve që nuk janë të komunës tone sepse e kemi të ndaluar. Sa i përket pikës të trete kur fole për arsim janë kriteret është komisioni që e vlerëson, është edhe afati i ankesave që munden me i ndjek procedurat secili.

Arbër Halilaj- foli për raportin ekzekutiv në asamble, ne këtu secili e përfaqësojmë një subjekt politik po para kësaj jemi njerëz dhe të kemi qasje njerëzore sidomos në komunikim, kisha kërkuar nga kryetari që drejtoret që nuk e kanë të qartë se çka kanë kompetencë e çka jo të jua sqaroj sepse para se gjithash se çka është nuk ka të drejtë, t'mu drejtohet në seancën e KPF-së me kërku raport se pse po voton kundër mem raportu me shkrim, ne dihet kujt i raportojmë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nuk votoni në KPF- pika të rendit të ditës asnjëherë e rekomandoni me shku në mbledhje të Kuvendit pra, kërkoj falje në emër tij që është sjellë në atë mënyrë. Komiteti për Politike dhe Financa e lehtëson në seancë diskutimin kur e rekomandon një pikë për kuvend. Rendin e ditës e bene kryetari i komunës në bashkëpunim me kryesuesin e komunës.

Zeqir Hasi, unë po e përcjelli një shqetësim të qytetareve në rrugën "Asllan Fazliu" kompania e ujësjellësit i ka kryer punimet në nëntor të vitit 2020 dhe pas përfundimeve të punimet kompania nuk e ka kthyer rrugën në gjendjen e mëparshme, qytetarët po detyrohen me e mirëmbajt vet atë pjesë nuk e di sa i lejohet komunës me intervenu në atë pjesë mirëpo duhet me dhënë dikush përgjegjësi sepse po bëhen një vit e gjysmë që qytetarët e asaj pjese e kanë të njëjtin problem.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, gropat që i hap qoftë kompania e ujësjellësit qoftë e kanalizimit, qoftë individ kompani e kanë se pari me kerku leje komunale sepse nëse vepron pa leje merr gjobë, kompania e ujësjellësit e ka pas një kontratë të nivelit qendror të cilën e ka prish kontratën dhe ne nuk kemi të drejtë me intervenu dikun ku dikush e ka bërë demin qapo me e riparuar por kompania ka marrë gjoba dhe jemi duke e ndjek si procedurë.

Filloreta Bujupi, e pati një kërkesë për Drejtorinë e Arsimit, në emër të grupit të asamblistëve të LL para jush paraqes shqetësimin e nxënësës të klasës të dymbëdhjetë me iniciale L.F nxënësja e shkollës të mesme profesionale "Fehmi Lladrovci" nxënësja në fjalë është nxënësja e shkëlqyeshme, mirëpo nxënësja në fjalë nuk mund të ec dhe lëvizjen e saj e

bënë përmes karrocës elektrike, ajo sfidohet çdo ditë me probleme për në shkollë, prindërit e saj kanë bërë kërkesë të vazhdueshme në komunë për t'ju siguruar transportin mirëpo mbështetja për bijën e tyre si prindër është e papranueshme, transporti i komunës është i domosdoshëm sidomos në kohën e dimrit kur rrugët për në shkollë janë të vështira të kalueshme për të dhe të rrezikshme, veç transportit nxënës në fjalë i duhet edhe material shtesë për mirëmbajtjen e karrocës të saj, dhe ky material është i papranishëm për tu siguruar nga familja, veç këtyre sfidave ajo dhe të tjerët që kanë nevojë të njëjta mund të kenë të vështirë të realizojnë lëvizjen me karrocë meqë trotualet dhe vendet e tjera janë të pa përshtatshme për këtë kategori.

Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka- për shqetësimin ngritur jemi në dijeni dhe e dina se për kë është fjala, ne për këtë kategori si drejtori e arsimit jemi duke e bërë maksimumin që nevojat e kësaj kategorie, për rastin konkret në fund të vitit të kaluar e merr një bursë në kuadër të shkollës profesionale të ultë meqenëse pajtohemi të gjithë me këtë, shtese që me ia lehtësu familjes që me e kry transportin me subvencionua më një shumë që me kry transportin mirëpo edhe i kemi kërkuar prindit me i sjelle gjitha dokumentet e nevojshme meqenëse ka qenë në fund të vitit dhe nuk kemi pas mundësi me i kry procedurat, tani në këtë vit e presim me alokimin e buxhetit dhe bartjen e buxhetit për këtë vit presim që me e subvencionua këtë nxënës dhe me një vlerë të caktuar buxhetore që besoj se do t'ju lehtësoj udhëtimin për në shkollë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, jemi e vetmja komunë që kemi ndarë buxhet për transportin e këtyre fëmijëve nuk e kemi vete atë kemi edhe të tjera raste, kemi bërë thirrje kompanive për transportin e kësaj kategorie mirëpo askush nuk ka aplikuar, mjetet të cilat i kemi të dedikuara nuk kemi të drejtë me i përdor për diçka tjetër ose me i përdor individualisht me ia paguar transportin sepse kodi buxhetor me i përdor.

Filloreta Bujupi, unë mendoj që komuna mundet me i rregulluar trotualet për kyçe për këta persona, nxënësja në fjalë çdo ditë i ka këto probleme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne i kemi rrugët për kyçe për këto kategori.

Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka- lidhur me rasti në fjalë apo për këtë kategori e vetmja mundësi që e kemi është me i subvencionua këtë kategori që e kemi në procedurë, sa i përket qasjes gjitha institucionet e kanë qasjen për këtë kategori, në gjimnaz jemi në proces të ndërtimit të një lifti për këtë kategori është donacion dhe shumë shpejt do të filloj projekti.

Florentina Elezi-Veliu, gjatë ditës së djeshme ka qarkulluar në media një lajm që aparati për analizën hemogram ka dal jashtë sistemit në Drenas dhe nuk është funksional mirëpo i njëjti problem është edhe në Komoran, momentalisht aparati për analizën e hemogramit nuk është funksional në Drenas, kur do të rregullohen ose a është rregulluar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne qofte se ka dal nga sistemi aparati edhe ndodh që prishen mirëpo për momentin nuk kemi kontratë është në zhvillim të procedurave dhe sigurisht që do të zgjatë kjo çështje.

Florentina Elezi-Veliu, tani sapo kam një kërkesë nga një qytetarë për personat që janë në hemodializë nuk kanë mjete për me i bartë personat që janë në hemodializë, komuna a ka me ndërmarrë diçka të tillë lidhur më këtë?

Drejtori i shëndetësie- Arsim Haxhiu- sa i përket personave që janë ne hemodialzië komuna ka vite që e ka të zgjidhur çështjen e transportit të këtyre rasteve, kontratën e kemi dhe transporti është për çdo ditë.

Valentina Leku, dua ta përmendi një çështje për shkollën fillore "Hasan Prishtina" në Llapushnik, e cila është lënë anash me investime, nga disa kërkesa më shqetësues është rrethoja e shkollës e cila është nisur por e lënë në gjysmë po ashtu rruga rreth shkollës është e pashtruar rreth 80 m, këto kërkesa janë adresuar të drejtori dhe po shpresojmë se do të implementohen, pastaj është rruga magjistrale për në shkollë paraqet rrezik pasi që nuk ka asnjë sinjalizim as parking, e dimë që ministria e infrastrukturës është përgjegjëse për këtë mirëpo ne si banor të Llapushnikut kërkojmë një bashkëpunim dhe se bashku ta bëjmë një zgjidhje. Kërkoj që kur po bëjmë homazhe tek varrezat herëve të tjera të shkojmë edhe në fshatin Llapushnik pasi që Llapushniku ka dhënë një kontribut te jashtëzakonshëm në luftën e fundit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, shqetësimet që i paraqite sa i përket rrethojës të shkollës jemi në proces dhe rregullimit të rrugës, sa i përket homazheve gjithë dëshmoret e Llapushnikut me pëlqim te banoreve i keni dërguar ne Negroc, ne bëjmë homazhe edhe ne Llapushnik edhe te pllaka me emra, mirëpo te njëjtin emra janë edhe në Morinë, pra kur shkojmë në Morinë jemi shku në çdo vend te rënieve të dëshmorëve

Pasi nuk pati diskutime te tjera mbledhja përfundoi në ora 12:15 min .

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 23.02.2022 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryeshteti i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-11828 dt. 15.03.2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë:
08.03.2022

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 26 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. “8 Marsi Dita Ndërkombëtare e Gruas.
 - a. Fuqizimi ekonomik i Grave .
 - b. Qasja institucionale për dhunën ndaj Grave.
 - c. Transporti publik dhe siguria për vajzat dhe gratë.
2. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400-49872, të datës 30.09.2021



Mbahet mbledhja e Jashtëzakonshme me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Me rastin e shënimit të 8 Marsit, Komuna e Drenasit së bashku me anëtarët e Kuvendit të Komunës, kanë mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme. Në këtë mbledhje morën anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës Ramiz Lladroci, nënkryetari i komunës Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale dhe qytetarë.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtarët e Kuvendit Komunal, Në bazë të nenit 43, pika 43.1, 44, 44.1, 44.2 dhe 44.3, të Ligjit nr. 03/L-40, për vetëqeverisje Lokale, neni 6, pika 1, të Udhëzimit Administrativë (MAPL) Nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës së Këshilltarëve të datës 02.03.2022, dhe në bazë të kërkesës së Kryetarit të Komunës të dt. 03.03.2022, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, më datë: 08/03/2022 mban mbledhje të jashtëzakonshme.

Egzona Tërdevci- në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale neni 44 pika 44.2 e drejta për të thirr një takim të jashtëzakonshme gjithashtu përfshinë të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar duke qenë se ne jemi thirrës të kësaj seance ne nuk kemi paraparë diçka tjetër për rendin e ditës përveç rendin për ditën ndërkombëtare të gruas, sugjeroj se pasi të përfundoj kjo pikë mundemi me thirr një seancë të re por pika e dytë të cilën ju po kërkon nuk mund të përfshihet në këtë takim të jashtëzakonshëm.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladroci- ju sa herë që i mbledhni nënshkrimet e nevojshme ne jemi gati për me mbajte seance të jashtëzakonshme, ndërsa rregullorja me numër 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të komunës, rendin e ditës nuk e bëni vetëm ju, kam te drejte edhe unë me venë pika për rend dite, mirëpo sot nuk kemi të drejte as unë e as ju me vene pika te reja për rend dite. Udhëzimi administrativ nr 02/2015 më rastin e mbledhjeve të jashtëzakonshme neni 6 pika 4 thotë e drejta për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për mbledhjen e caktuar, rendi i ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund te ndryshohet apo plotësohet është në dorën e juaj.

Egzona Tërdevci- ligji për vetëqeverisje lokale është ligji bazik dhe ligji kryesor mbi të cilin funksionojmë si kuvend komunal, por nëse ju vazhdoni me të njëjtën pas seance nune do t'i drejtohem MAPL-së me një shkresë për sqarime të mëtutjeshme.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 21 anëtar dhe votuan me: *10 vota (Për), 3 vota (Kundër), 8 vota (Abstenim)* miratohet rendi i ditës.

Milaim Hajdari- Kryesues- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. 8 Marsi Dita Ndërkombëtare e Gruas.**

- a. Fuqizimi ekonomik i Grave .
- b. Qasja institucionale për dhunën ndaj Grave.
- c. Transporti publik dhe siguria për vajzat dhe gratë.

Milaim Hajdari- Kryesues Në të gjithë botën kjo është një ditë që njihet si dita ndërkombëtare e gruas. Gratë sot protestojnë për të drejtat e tyre, jo vetëm në vend ku të drejtat janë apriori të mohuara, por edhe në vende kur ne shohim shembullin e realizimit të këtyre të drejtave. Ky është një tregues kuptimplotë për faktin se edhe bota e qytetëruar të cilës duam t'i bashkangjitemi në bashkimin evropian, apo në aleancën e madhe të vendeve demokratike ka ende shumë për të bërë për të drejtat e grave. Për të shprehur përgjithësisht mirënjohjen për të gjitha gratë shqiptare, që edukuan gjenerata të tëra fëmijësh, me respektin për vlerat njerëzore dhe për ato kombëtare. Për të nënvizuar respektin për të gjitha ato gra, të njohura ose jo, që bënë edhe më shumë qysh në kohëra të hershme, duke kapërcyer pragun e shtëpisë, duke ndikuar në një mënyrë ose në një tjetër drejtpërdrejtë në jetën e vendit tonë. Duke ngritur lartë veprat që mbart respekt të pafund e që na dhanë jete nga jeta e tyre si Heroina Xhevë Krasniqi Lladrovci, Fatime Hetemi, Antigona Fazliu, Ganimete Gjylani e të tjera.

Me këto fjalë dua të çmoj sot në mënyrë të posaçme, të gjitha gratë që luftojnë për të mbrojtur të drejtat e tyre, të gjitha gratë që me sa munden rritin hapësirën dhe vëmendjen për gruan, qoftë duke u angazhuar në përpjekjen e shoqërisë civile, apo qoftë duke dhënë shembuj në rolin e gruas në politikë, por edhe në sipërmarrje. Unë jam krenar që shembuj të tillë inkurajues dhe frymëzues kemi këtu mes nesh, në vijën e parë të angazhimit të përbashkët, për një shoqëri të lirisë, barazisë dhe vëllazërimit. Për një shoqëri të drejtë për çdo njeri, pavarësisht gjinisë, fesë, ngjyrës së lëkurës dhe të barabartë në mundësitë që i ofron gjithsecili. Unë do doja të mbyllja këtë fjalim duke uruar çdo gruaje, çdo nëne, çdo motre Urime 8 Marsin Dita ndërkombëtare e gruas.

Egzona Tërdevci- Sot për 8 Mars në ditën ndërkombëtare të gruas kemi thirr një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar për gratë dhe vajzat, sfidat me të cilat ato ballafaqohen e problemet që i shoqërojnë në baza ditore por para se të nis diskutimin dua ti përmend disa vajza e gra të jashtëzakonshme, të cilat me atdhedashurinë, guximin e sakrificën e tyre do të mbesin përherë pjesë e historisë sonë, sot kujtojmë Xhevë Lladrovcin, Fatime Hetemin, Fatime Bazajn, Antigona Fazliun, Ganimete Gjylanin, Luljeta Shalën e shumë vajza e gra të tjera për të cilat gjenerata e breza të tërë do të flasin me krenari.

Veç krenarisë lufta na la edhe shumë dhimbje mbrapa, të gjithë humbëm shumë, por gratë i vuajtën pasojat më shumë se gjithë të tjerët, unë sot nuk dua të flas për numrin e grave që u

dhunuan seksualisht gjatë luftës sepse nuk dua ti reduktojmë gratë vetëm në shifra, dua të flas për trajtimin që ua kemi bërë pas luftës këtyre grave, po bëhen 23 vjet nga përfundimi i luftës e pak nga këto gra gëzojnë statusin e viktimës së dhunës seksuale, por veç rolit të shtetit barrën nuk ua kemi bërë më të lehtë as ne si shoqëri, ne kemi vazhduar ti paragjykojmë, ti stigmatizojmë e ti përjashtojmë nga shoqëria këto gra, është koha e fundit që këto gra të kenë zë, është koha e fundit që ne ti dëgjojmë thirrjet e tyre e ti bëjmë të ndihen pjesë e barabartë e shoqërisë tonë, të gjithë ne nga pozicionet që kemi jemi të obliguar që të flasim më shumë për këto gra, ti dëgjojmë më shumë e tua bëjmë më të lehtë integrimin në shoqëri.

Pavarësisht kohëve, siguria e vajzave dhe grave vazhdon të mbetet sfidë edhe në ditët e sotme, numri i rasteve të ngacmimeve seksuale, rrahjeve, dhunimeve e vrasjeve është në rritje kohët e fundit.

Fatkeqësisht raste të tilla jo rrallë dëgjojmë edhe nga komuna jonë, e rastet e dhunës në familje në Drenas dhe jo vetëm del se janë shtuar shumë përgjatë kohës së pandemisë.

Në mënyrë që të jemi më afër qytetarëve tanë të cilët mund të përballen me dhunën në familje dhe jo vetëm është e nevojshme ngritja e Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje, i cili tashmë është funksional në disa komuna, pjesë e këtij mekanizmi Koordinues duhet të jenë Zyrtarët për Barazi Gjinore, Policia e Kosovës, Gjyqtarët, Qendra për Punë Sociale, Mbrojtësit e Viktimave, Drejtoria Komunale e Arsimit, Zyra e Punësimit, Organizata të Shoqërisë Civile dhe akterë të tjerë relevantë.

Veç këtij mekanizmi janë edhe disa forma të tjera me të cilat pushteti lokal mund të angazhohet në mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës mbi baza gjinore, DKA-ja duhet të punoj në vetëdijesimin e gjeneratave të reja lidhur me dhunën në familje dhe pasojat e saj, por edhe të ndihmoj në identifikimin e rasteve të dhunës duke komunikuar vazhdimisht me fëmijët dhe prindërit e tyre nëpërmjet mekanizmave që posedojnë shkollat, Drejtoria e Shëndetësisë duhet të gjej forma për të përgatitur edhe më shumë stafin e QPS-së dhe QMF-ve lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pasi nga hulumtimet e bëra nga shoqëria civile këto institucione në nivel vendi nuk qëndrojnë mirë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Për vajzat e gratë është jashtëzakonisht e rëndësishme pavarësia ekonomike, statistikatat në këtë drejtim lënë shumë për të dëshiruar, pak gra janë të përfshira në tregun e punës, pak gra drejtojnë biznese e edhe më pak gra trashëgojnë pasuri.

Nga pozicioni i qeverisjes lokale janë disa hapa që mund t'i marrim që tua lehtësojmë vajzave dhe grave përfshirjen në tregun e punës.

Transporti publik vazhdon të jetë sfidë për qytetin tonë, duke qenë se linjat e fundit të autobusëve për fshatrat e Drenasit janë në ora 18:15 e ajo nga kryeqyteti për në Drenas në ora 20:15, ky është shqetësim edhe për vajzat studente që mund të kenë ligjërata pasdite por edhe për vajzat dhe gratë që punojnë në orarin e pasdites, e ky shqetësim rritet edhe më shumë në kohën e pushimeve vjetore të nxënësve kur transporti për fshatra është thuajse jo funksional, si komunë ne duhet të gjejmë mundësinë për të zgjatur orarin e qarkullimit të linjave nga kryeqyteti dhe sinkronizimin e këtyre linjave me autobusët lokalë edhe pas orës 18:00.

Një arsye pse shpesh gratë përjashtohen nga tregu i punës është edhe krijimi i familjes nga to, për shkak se vijnë nga shoqëri patriarkale e kemi të mbjellur idenë se vetëm gratë duhet të kujdesen për fëmijët dhe pavarësisht vetëdijesimit të burrave kjo barrë vazhdon të rëndo

akoma tek gratë, që një grua me fëmijë të punoj ajo ka nevojë për një vend që do të përkujdeset për fëmijën e saj, si komunë duke pasur vetëm një çerdhe publike ne nuk qëndrojmë aspak mirë në këtë aspekt, veç dy çerdheve të reja që do të ndërtohen ne do të duhej të shqyrtonim edhe mundësinë për ndërtimin e çerdheve me bazë në komunitet por po ashtu të shohim mundësinë që nënat vetushqyese që punojnë dhe ato që kanë më shumë se dy fëmijë të kenë ndihmë nga komuna në formë të subvencionimit të çerdheve për fëmijët e tyre.

Veç veprimeve me transport dhe çerdhe komuna duhet ti mbështes edhe vajzat sportiste, të gjithë jemi dëshmitarë se klubet e djemve të qytetit kanë marrë më shumë fonde nga komuna sesa ato të vajzave.

Pavarësisht gjithë sfidave të përmendura më lart ne kemi shënuar progres në luftën për barazi gjinore, sot një grua qëndron në krye të shtetit tonë, shumë gra janë të përfshira në qeverisjen qendrore e atë lokale të shtetit, niveli i përfaqësimit gjinor në Kuvendin e Republikës tonë krahasohet me atë evropian, çdo ditë dëgjojmë për storie suksesi të vajzave e grave brenda dhe jashtë vendit tonë, por akoma mbetet shumë punë për tu bërë, e këtë mund ta bëjmë kur ne angazhohemi për secilën grua, të fshatit e qytetit tonë, pavarësisht statusit social, përgatitjes profesionale e pozicionit në shoqëri, jo të gjitha vajzat e gratë kanë zë e ne që kemi, e kemi për obligim të jemi edhe zëri i tyre, ne jemi më të forta vetëm kur e ngrisim njëra-tjetrën, askush nuk i kupton e nuk mund ti ndihmoj gratë më shumë se ato njëra-tjetrën por për të arrit barazi në shoqëri këtë rrugëtim duhet ta bëjmë bashkë me djemtë e burrat që synojnë një shoqëri ku vlerat e barazisë janë fundament i shoqërisë.

Arbër Halilaj- Jemi mbledhur në këtë seancë të jashtëzakonshme jo për të festuar, siç do të duhej, por mu në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, të diskutojmë për pozitën diskriminuese të saj në shoqëri!

Dhuna në familje dhe sidomos dhuna ndaj gruas ka ardhë gjithnjë e duke u rritur në Kosovë, si një shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtave të njeriut, deri tek privimi nga e drejta për jetë. Kosova ka një kornizë ligjore të harmonizuar sa i përket dhunës në familje, që përfshinë një sërë ligjesh, politikash dhe mekanizmesh që e luftojnë këtë fenomen.

Nisur që nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22 i saj, theksohen disa konventa ndërkombëtare drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Kosovë, që madje kanë prioritet edhe ndaj dispozitave ligjore vendore, siç janë:

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – e njohur si Konventa e Stambollit.

Trajtimi i fenomenit të dhunës në familje, e sidomos dhunës ndaj gruas, duhet të jetë lartë në listën e prioriteteve të çdo Qeverie, komune a institucioni tjetër shtetëror, që mund të ndërmarrin hapa konkret në ngritjen e kapaciteteve e të mekanizmave institucional që do të ofronin mbrojtje më të madhe nga kjo dhunë. Në këtë vazhdimësi të hapave dhe aktiviteteve, Kosova duhet të hartojë dhe zbatojë një Strategji Kombëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna, duke paraparë edhe masa konkrete parandaluese për ndërprerjen e kësaj forme të

dhunës, e ku fuqizimi ekonomik i grave, favorizimi në punësim, prioritizimi në zgjidhjen e çështjes së banimit etj. do të ishin disa nga hapat parandalues.

Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së botës, ndërsa në Kosovë struktura gjinore sidomos pas luftës konsiderohet të ketë ndryshuar shkaku i emigrimit të meshkujve, duke pasur tani pjesëmarrje më të lartë të popullsisë femrore me 51.2% sesa ajo mashkullore me 48.8%. Përkundër kësaj, gratë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë dhe nuk e ndajnë pushtetin ekonomik me meshkujt, edhe pse janë pjesëmarrëse aktive, të suksesshme dhe bartëse të ndryshimeve shoqërore, duke qenë vendimmarrëse në politikë, në ekonomi dhe zhvillim social, në strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë, në shkencë dhe arsim, arte dhe kulturë, bujqësi, sport dhe turizëm, biznes dhe në shumë sfera tjera, ku iu është dhënë mundësia dhe ku kanë dëshmuar arritje kulminante.

Diskriminimi sistematik në raport me meshkujt, vërehet jo vetëm në pozitën e pafavorshme të grave në organet legjislative, por edhe në organet ekzekutive. Në pothuajse të gjitha kabinetet qeveritare të Kosovës, burrat kanë dominuar dukshëm në krahasim me gratë, sa i përket udhëheqjes së dikastereve e ministrive. Në një vend që deri më tani është qeverisur keq pikërisht nga burrat, gratë kanë potencialin, vullnetin dhe profesionalizmin e duhur që me kontributin dhe ndikimin e tyre të sjellin ndryshime për të mirë në shoqërinë tonë. Megjithatë, ato ende nuk po e kanë besimin e duhur nga qytetarët dhe kolegët e tyre që të jenë më të përfaqësuara në politikë.

Fuqizimin ekonomik i grave dhe hapat tjerë që përmenda më herët janë çelësi që ndikon në uljen e shkallës së dhunës ndaj grave, por jo vetëm kaq, meqë direkt do të ndikonte pozitivisht edhe në rritjen ekonomike të vendit, zvogëlimin e shkallës së varfërisë dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm të Kosovës. Pjesëmarrja më e madhe e grave në politikë, në biznes, si dhe në të gjitha sferat shoqërore është vendimtare për tejkalimin e ndasive dhe divergjencave brenda shoqërisë sonë.

Prandaj, një nga qëllimet kryesore të shoqërisë sonë duhet të jetë rritja e pjesëmarrjes dhe e përfaqësimit të grave në jetën institucionale, në proceset shoqërore dhe përmirsimi i statusit të tyre ekonomik. Grave duhet t'iu mundësohet që të kenë një rol dhe kontribut më të madh dhe më të rëndësishëm në shoqëri, duke shfrytëzuar potencialin e madh të tyre në të mirën e përgjithshme. Duhet të rrisim bashkëpunimin ndërkomunal të grave në të gjithë sektorët ku janë aktive, pastaj rritja e involvimit të grave në aktivitetet politike e shoqërore, promovimi i tyre në pozita të larta vendimmarrëse dhe të pushtetit, të gjitha këto në të mirë të krijimit të stabilitetit në shoqëri dhe forcimit të ekonomisë.

Kjo gjithëpërfshirje e grave në shoqëri mbetet obligim i të gjithë neve, gra e burra së bashku, sidomos tani e tutje në rrethanat e ndryshuara pas Covid-19 dhe sidomos pas luftës në Ukrainë. Këto zhvillime të papara ndonjëherë, të përcjellura me kriza të mëdha ekonomike në tërë Evropën dhe në rajonin tonë, ndihen nga të gjitha shtresat e shoqërisë, por më të ndikuarat nga efektet dhe në pozitën më të pafavorshme janë femrat. Duke pasur pozitë të pabarabartë dhe përfshirje më të vogël në shoqëri, ekonomi dhe në tregun e punës, ato goditen të parat dhe më së keqi, pushohen më lehtë nga puna, iu shkelen të drejtat tjera të garantuara siç është pushimi i lehonisë, paguhet më dobët për të njejtën punë që bëjnë sikurse meshkujt, nuk kanë trajtim të barabartë kur aplikojnë për punë etj.

Edhe statistikat flasin për një diskriminim të qartë gjinor në tregun e punës. Papunësia tek gjinia femërore është 29.7 %, krahasuar me meshkujt 24.2%. Shkalla e punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e parë 2021 është 29.3 %, ku punësimi më i lartë është te meshkujt 42.8 %, ndërsa te femrat 15.9 për qind. thuhet në raportin e publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Femrat janë të punësuara kryesisht në sektorët ekonomik më pak të paguar, si në arsim, tregti, industrinë e tekstilit, të përpunimit të qumështit dhe në kujdesin shëndetësor, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimitarisë, tregtisë dhe prodhimit. Edhe tek pjesa e popullsisë së re që është e

papunë (48.6%), shkalla e papunësisë tek rinia e gjinisë femërore është më e lartë (53.5 %) krahasuar me meshkujt e rinjë (46.1%).

Nëse kthehemi tek lufta e UÇK-së, gratë e kanë dëshmuar rolin, fuqinë dhe gjenin e tyre luftarak, duke marrë armët dhe duke dhënë edhe jetën që brezi i tanishëm të mos përjetojë kurrë më pushtimin serb. Por, asnjëherë deri më sot nuk është vlerësuar njësoj kontributi i grave sikurse i burrave, pavarësisht trimërisë dhe guximit të vajzave e grave luftëtare të UÇK-së. Gruaja më e njohur luftëtare në Kosovë është Xhevë Lladrovci, që luftoi dhe ra në front së bashku me bashkëshortin, heroin emblematic Fehmi Lladrovci. Shtatore të bronzta të dëshmoreve tona rrallë i shohim nëpër sheshet e qyteteve, por as veteranet e luftës së fundit, që çuditërisht janë vetëm 3036 sosh, nuk i shohim nëpër ndarje dekoratash, mirënjohjesh e manifestimesh përkujtuese. Në një shoqëri patriarkale sikurse kjo e jona, qasja e padrejtë ndaj luftës së grave në UÇK krijon paragjykimet dhe deformim të realitetit historik.

Arsimi dhe shkencat janë gjithashtu nga fushat kryesore dhe më kritike të fuqizimit të rolit të grave në shoqëri, por edhe fusha që ofrojnë disa nga shembujt më të qartë të diskriminimit të cilit i ekspozohet një grua. Në mënyrë që gratë të kenë një shans për një jetë më të shëndetshme dhe më të lumtur, është e nevojshme t'u jepet mundësia për arsimim dhe përparim në arsim, shkencë dhe inovacione. Këtu do të kishte edhe përfitime të mëdha për shoqërinë në tërësi, sepse një grua e arsimuar ka njohuritë, informacionin dhe vetëbesimin që i nevojiten për të qenë një prind, punëtorë dhe qytetare më e mirë. Gratë e arsimuara janë në gjendje të sjellin ndryshime socio-ekonomike, ku janë dëshmuar më të zonjat sesa burrat. Përparimi i vërtetë i grave në të gjitha fushat është sfida e shoqërisë sonë dhe ka një rëndësi të madhe. Shihet qartë se si pasojë e dominimit mashkullor në të gjitha sferat e jetës, pabarazia politike dhe ekonomike në dëm të grave është e pranishme dhe ka të bëjë edhe me qëndrimet ekzistuese patriarkale dhe tradicionale, stereotipet e pranishme në shoqëri, mungesën e mbështetjes financiare institucionale etj.

Ne si institucione duhet që paralelisht me insistimin e qartë për zbatimin e dispozitave ligjore në mbrojtje institucionale të grave nga dhuna, që është një njollë e zezë e shoqërisë sonë, të përpiqemi për të lehtësuar zhvillimin e tyre profesional, për të thjeshtuar kushtet e të bërit biznes për gratë, të krijojmë qasje favorizuese dhe të drejtë në tregun e punës, të krijojmë kushte për punë të pavarur të grave, duke iu mundësuar atyre para së gjithash sigurinë ekonomike dhe stabilitetin, që e lehtëson pastaj edhe aspektin e pavarësisë në shoqëri dhe sigurinë e tyre fizike. Kjo do të ndikonte në zhvillimin e përgjithshëm të vendit si dhe do të mund të parandalonte migrimin sidomos të të rinjve të shkolluar jashtë vendit.

Për fund, them që duhet të jeni krenarë dhe ballë hapura për heroizmin e të kaluarës, përkushtimin e së tashmes dhe mundësitë e së ardhmes për Ju. Bota pa gruan do të ishte një ferr i heshtur. Urime festa nënës sime, bashkëshortes sime. Urime festa juve kolege dhe të gjitha grave në botë!

Beqir Kiqina- Data 8 Mars është një ditë e veçantë, e cila ditë në mbarë botën festohet përkujtohet por mbi të gjitha edhe protestohet për të drejtat e grave, pra për të drejtën jetike e barabartë e cila garanton liri, barazinë dhe vendimmarrje, andaj ne si vend jemi krenar me kontributin e grave që kanë dhënë historikisht në etapat historike që nga Iliret, Arbërit dhe deri tek ne shqiptarë, gruaja ishte përherë e pranishme në të gjitha proceset që nga Mbretëresha Teutë në periudhën Helenistike e deri të Elena Gjika në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, pastaj edhe kontributi i grave shqiptare ishte i padiskutuar në lëvizjen për liri e pavarësi që nga vitet e 60-ta të shek.-XX gruaja ishte ajo e cila i dha shumë vendit dhe na nderoj edhe në nivele ndërkombëtare, pra është e paharruar kontributi i Nënës Tereze, gratë ikonë i gjejmë çdo kund, i gjejmë edhe tek lufta e UÇK-së kontributin epik që qëndronin krenarë dhe kanë dhënë krejt çka kishin madje edhe jetën për këtë vend. Fjalët janë

të pakta kur përmendim nënën Zahide Jashari, nënën e Komandantit Adem Jashari e cila mbetet e paharruar për atë që i dha Kosovës e cila bashke me djemtë dhe burrin i qëndruan armikut përballë, po ashtu nëna Salë Jashari e cila priti e përcolli e cila iu gatoj shumë trimave të lirisë e me këtë na bëri krenare me një krenari të madhe, nena ikonë mbetet edhe nëna e lirisë Aza Brahimaj e cila po ashtu priti e përcolli shumë e shumë trima nga të gjitha viset shqiptare e po ashtu në luftë me armikun bie heroikisht në altarin e lirisë që ne sot të jetojmë të lirë, pa diskutim që edhe komuna jonë ka pasur shumë gra të shquara e simbol i gruas mbetet trimëresha Xhevë Lladrovci e cila sikur të ishte Shote Galica nuk pushoj asnjëherë në luftë me armikun e bie në përjetësi.

Vitet e fundit krenar na kanë bërë edhe Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distrie Krasniqi në sportin e gjudos të cilat ngritën lartë flamurin deri në Rusi. Pavarësisht arritjeve që nga viti 1999 e deri me tani institucionet në nivel lokal dhe qendror kanë bërë përpjekje për avancimin në rolin e gruas mirëpo mbetet ende shumë për tu bërë, andaj kërkoj edhe nga ekzekutivi i komunës tonë të bëjë edhe me shumë përpjekje në avancimin e gruas dhe krijimin e kushteve më të mira si në punë, përkrahje dhe në ekonomi dhe lehtësimin e kushteve të atyre grave të të berit biznes, por edhe tu jepet përkrahje e vazhdueshme atyre grave të cilat janë të mbijetuara të dhunës gjatë luftës. Urime gjitha grave dita e 8 Marsit.

Azemine Bujupi-Gjoka – 8 Marsi është data kur në të gjithë botën festohet Dita Ndërkombëtare e Gruas, e cila nuk është një ditë e feminizmit ekstrem, por momenti kur të gjithë jemi të ftuar të reflektojmë për çështje që lidhen me botën femërore mbi arritjet e mëdha, çështje sociale e politike që lidhen me mundësi të barabarta dhe hapat e ardhshëm që duhet ndërmarrë për të kapërcyer boshllëqet që ende ekzistojnë.

Nën sytë e njerëzimit vazhdon lufta ndaj të gjitha diskriminimeve dhe dhunës ndaj gruas.

Në të gjithë botën gratë vazhdojnë të ngrenë zërin e protestës për të luftuar kundër shkeljeve të shpeshta të së drejtës për të qenë të sigurt e për të qenë të lira në zgjedhjet e tyre.

Disa avantazhet profesionale dhe ekonomike janë disa çështje për të cilat gratë në të gjithë botën vazhdojnë të luftojnë, edhe pse është e vërtetë që janë bërë shumë hapa përpara, veçanërisht në vendet Perëndimore, është gjithashtu po kaq e vërtetë që rruga drejt barazisë gjinore dhe emancipimit social është ende e gjatë.

Kosova të drejtën e gruas e ka të rregulluar me ligj por, pavarësisht të drejtave të grave për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në qeverisje demokratike apo dhe aftësitë e vullnetin e tyre për tu dëshmuar si udhëheqëse të suksesshme, praktikat në shoqërinë tonë kanë tendencë ti japin gruas më pak zë politik dhe fuqi të kufizuar vendimmarrëse.

Urime 8 Marsin të gjitha grave shqiptare kudo në botë.

Marigona Bazaj-Më lejoni që unë si vajzë në radhë të parë të urojë nga zemra të gjitha nënave, grave në diasporë, mësueset e nderuara që ndër vite sjellin gjenerata të arta, nënat dhe motrat e të pa gjeturve në Kosovë, uroj që 8 Marsi i vitit 2022 të jetë i fundit që ato kërkojnë më të dashurit e tyre, dhe që dhimbja e tyre e përjetshme të zbutet sado pak. Kjo ditë shënuar në Kuvendin e Drenasit është shumë domethënëse për të gjithë, është mbase një moment i veçantë që ne tok së bashku të reflektojmë dashurinë, kreativitetin dhe përkushtimin të gjithanshëm për një të ardhme më të mirë dhe të begat.

Nisur nga kjo festë dua të them që, kur është çështja të besimi qytetarë gratë e gëzojnë më pak në raport me burrat, është problem që i ka rrënjët ndoshta në edukim fillestar, frymën

patriarkale në të cilën jemi rritur, sistemin arsimor e shumë të tjera që kanë ndikuar në perceptimin e gabuar të qytetarëve Kosovarë, ndaj grave në politikë. Të gjithë jemi dëshmitarë të diskriminimit të grave në shoqërinë tonë, ajo vazhdon fatkeqësisht edhe në Komunën tonë, ku kryetari i tanishëm mburret me përfaqësimin gjinor në qeverisjen e tij, por ato i përdorë vetëm për të dalur mirë në fotografi.

Atyre iu cenohet e drejta e shprehjes së lirshme apo marrjes së vendimeve, përderisa një pyetje që parashtrohet për "X" drejtorinë ku udhëhiqet nga një grua, ai asaj pyetje i përgjigjet vetvetiu çdo herë. Kjo vërtetë është për keqardhje sepse një grua(femër) përveç se është shtylla e shtëpisë, ajo nuk di vetëm të lajë, pastrojë, të rrisë fëmijët. Ajo mund të jetë një lidere e shkëlqyer një politikane e zonja, raste të tilla kemi në mbarë botën ku ajo ka dëshmuar vetën e saj me punën e saj të suksesshme siç janë: Hilary Clinton, Angela Merkel, Medelin Olbrait etj.

Mjafton t'ia ofroni mundësinë dhe ajo do shkëlqejë.

Albulena Saliuku- 8 Marsi në të gjithë botën njihet si Dita Ndërkombëtare e Gruas. Andaj kjo ditë kaq e rëndësishme na shërben për të kujtuar përpjekjet e grave për barazi. Kujtojmë sakrificën dhe kontributin e dhënë të të gjitha nënave, grave dhe vajzave shqiptare. Ndihej mirë që komuna jonë e ka ngritur pozitën e gruas në shumë dimensione dhe do të jem përkrahëse gjithmonë për fuqizimin e gruas në politikë, vendimmarrje dhe më gjerë. Me rastin e 8 Marsit i uroj të gjitha nënat dhe gratë kudo që janë!

Mërgim Pirraku- uroj festën e 8 Marsit të gjitha nënave që me sakrificë dhe me mund na kanë rritur e na kanë edukuar dhe për të gjitha gratë dhe motrat tona që janë krenaria jonë për të gjitha gratë që e frymëzuan brezat e rinjë për ta dashur atdheun e për të punuar me ndershmëri ndaj shtetit. Vërtetë ndihem i turpëruar që në kohën tonë duhet të organizojmë mbledhje të jashtëzakonshme për të debatuar për të drejtat e grave edhe pse shoqëria jonë është e përparuar në këtë aspekt, ne kemi shumë punë për të bërë në këtë drejtim. Kërkoj se pari nga vetja dhe nga secili qytetar të jemi përkrahës i pakompromis për të drejtat e grave në shoqërinë tonë.

Hamit Haxhiu- Urime festa e 8 Marsit, të gjitha nënave dhe motrave tona. Gruaja nuk mund të themi se gjithmonë ka qenë e privilegjuar me të drejta të veta për ekzistencë, punë, edukim dhe trashëgimi. Gruaja shqiptare gjithmonë është parë si një simbol i vyeritit punës, sakrificës, përkushtimit dhe besës. Gruaja shqiptare është paraqitur si një mbrojtëse e vlerave shtetërore, familjare dhe shoqërore. Pas viteve të 90-ta, gruas dhe vajzave iu dha mundësia të kenë rol të barabartë gjinorë. Të drejtat e grave janë të drejta themelore të cilat u ruajtën nga Kombet e Bashkuara për çdo qenie njerëzore. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, nuk janë vetëm të drejta njerëzore, ato janë gjithashtu të domosdoshëm dhe për rritjen e një zhvillimi gjithë përfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm. Edhe roli i saj në familje ka ndryshuar, nëse dikur familjet ishin patriarkale, sot ka një balancim të autoriteteve dhe mendimi gruas ka shumë peshë. Edhe një herë urime festa e 8 Marsit të gjitha nënave dhe motrave tona.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- duke uruar Ditën Ndërkombëtare të Gruas, ka theksuar se këto data duhen të jenë momente reflektimi për të gjithë ne, për të parë sa e gjatë,

sa e mundimshme e sa sfiduese ka qenë e kaluara jonë, e në këtë drejtim roli i femrës në shoqërinë kosovare ka qenë jetik.

“Në këtë ditë të shënuar, përgëzoj nënat, gratë e motrat që më përkushtim u vunë në shërbim të atdheut, u bënë krah i baballarëve, vëllezërve e burrave të vet, me pushkë e me pendë, në të gjitha mënyrat, për arritjen e lirisë së Kosovës.

Në këtë ditë, kujtojmë me nderim të thellë, heroinën Xhevë Krasniqi-Lladrovci, mësuesen dhe edukatoren, luftëtaren dhe bashkëshorten, që nëpërmjet personalitetit të saj, edhe të gjitha gratë që dhanë kontributin për çlirimin dhe përparimin e vendit tonë.

Nderimi dhe respekti më i madhe që mund dhe duhet t’i bëhet atyre sakrificave është që punët tona t’i kryejmë me nderë, përkushtim dhe profesionalizëm, që ligji dhe zbatimi i tij të jetë udhërrëfyes i punës sonë.

Gratë nuk duan vetëm lule, natyrisht se lulet janë më se të mirëseardhura, por para kësaj gratë duan shance të barabarta, duhet t’u jepet mundësia për të dhënë kontribut, unë e kam bërë dhe po e bëjë këtë, e kam bërë që kur kam ardh në krye të Komunës, e kam bërë dhe jam krenar për këtë.

E kam bërë sepse këtë ma ka determinuar e kaluara ime, trangu im familjar, ngase jam rritur dhe edukuar me ndjesinë e barabarësisë së burrit dhe gruas, kjo barabarësi e dëshmuar deri në vet-flijim.

Unë kur e vendosa standardin 50% të drejtorëve gra dhe 50% burra, në fund të vitit 2016, një standard të tillë nuk e kishte asnjë komunë e as institucion, e bëra unë, bëra mirë”, ka thënë kryetari Lladrovci.

Drejtori i inspeksionit- Petrit Gashi- Së pari shfrytëzoj rastin që në këtë seance të gjithë ju gra e vajza asambliste dhe përmes këtij kuvendi të gjithë grave në Kosovë të ja urojme festën e 8 Marsit, Ditën ndërkombëtare të gruas që përkujton lëvizjen për të drejtat e grave.

Në fakt kjo seancë e thirrur si e jashtëzakonshme do duhej të ishte seance solemne, sepse avancimi i drejtave të grave në komunën tonë është shndërruar jo vetëm model për Kosovën por edhe për vende të tjera. Kjo e drejtë në të cilën i është garantuar si askund në Kosovë, qoftë në përfaqësimin komuna në drejtori, qoftë në arsim, qoftë në administratë apo edhe në sektor të tjerë me rëndësi për vendin e ka burimin e vet edhe të një kulturë e vazhdueshme që qytetaret e Drenasit kanë pasur pothuajse me dekada e shekuj.

Në këtë ditë, që duhej të ishte një feste për promovim të të drejtave të gruas, tanimë Drenasi është vërtet kampion sepse në institucionet e saj qeverisëse i ka 50% me 50% në udhëheqje të barabartë nga gratë, në administratë e arsim dominojnë gratë, në shkollim kemi fatin e mirë që kemi trend pozitiv të shkollimit të femrës dhe në këtë aspekt, si një prind i dy vajzave nuk mund të them që nuk jam i lumtur për një avancim të tillë.

Kjo është arritur falë një qeverisje që i është dhënë hapësirë e madhe gruas, asaj gruaje që tradicionalisht ka pasur hapësirë në shtëpitë tona, dhe një nga shembujt më të mirë ishte edhe Xheva e Fehmiu që ngjasonim në Shotën e Azemin e kohës moderne.

Valentina Leku- nocioni i të drejtave të grave përfshinë përfshin të drejtë e integritetit trupor dhe autonominë, e drejta e lirisë nga dhuna seksuale, e drejta e votimit, e drejta e barazisë, e drejta për të punuar, e drejta në paga, e drejta e zotërimit të pronës, në arsim-edukim, një e drejtë e cila nuk u përmend më parë vajzat, femrat, gratë kanë të drejtë në besimit dhe praktikumit të hapur të besimit të tyre të cilat shpesh privohen, diskriminohen nga e drejta e punësimit dhe shkollimit, kjo nuk duhet të mbetet vetëm për 8 Mars të përmenden vetëm nevojat dhe të drejtat e grave por gjithmonë duhet të mbetet e rëndësishme aty ku nuk kemi arritur t’i japim ndihmën e duhur femrave sepse ato nuk meritojnë vetëm për 8 Mars por

duhet çdo ditë të kuptojmë të ndijim vlerën dhe rëndësinë e tyre. Uroj 8 marsin gjitha nënave ne bote, mirënjohëse dhe i përulëm çdo nene që ka kontribuar secila në mënyrën e vet.

Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik Egzona Jetullahu- Sot për 8 Mars në ditën ndërkombëtare të gruas kemi thirr një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar për gratë dhe vajzat, sfidat me të cilat ato ballafaqohen e problemet që i shoqërojnë në baza ditore por para se të nis diskutimin dua ti përmend disa vajza e gra të jashtëzakonshme, të cilat me atdhedashurinë, guximin e sakrificën e tyre do të mbesin përherë pjesë e historisë sonë, sot kujtojmë Xhevdën Lladrovcin, Fatime Hetemin, Fatime Bazajn, Antigona Fazliun, Ganimete Gjylanin, Luljeta Shalën e shumë vajza e gra të tjera për të cilat gjenerata e breza të tërë do të flasin me krenari.

Veç krenarisë lufta na la edhe shumë dhimbje mbrapa, të gjithë humbëm shumë, por gratë i vuajtën pasojat më shumë se gjithë të tjerët, unë sot nuk dua të flas për numrin e grave që u dhunuan seksualisht gjatë luftës sepse nuk dua ti reduktojme gratë vetëm në shifra, dua të flas për trajtimin që ua kemi bërë pas luftës këtyre grave, po bëhen 23 vjet nga përfundimi i luftës e pak nga këto gra gëzojnë statusin e viktimës së dhunës seksuale, por veç rolit të shtetit barrën nuk ua kemi bërë më të lehtë as ne si shoqëri, ne kemi vazhduar ti paragjykojmë, ti stigmatizojmë e ti përjashtojmë nga shoqëria këto gra, është koha e fundit që këto gra të kenë zë, është koha e fundit që ne ti dëgjojmë thirrjet e tyre e ti bëjmë të ndihen pjesë e barabartë e shoqërisë tonë, të gjithë ne nga pozicionet që kemi jemi të obliguar që të flasim më shumë për këto gra, ti dëgjojmë më shumë e tua bëjmë më të lehtë integrimin në shoqëri.

Pavarësisht kohëve, siguria e vajzave dhe grave vazhdon të mbetet sfidë edhe në ditët e sotme, numri i rasteve të ngacmimeve seksuale, rrahjeve, dhunimeve e vrasjeve është në rritje kohët e fundit.

Fatkeqësisht raste të tilla jo rrallë dëgjojmë edhe nga komuna jonë, e rastet e dhunës në familje në Drenas dhe jo vetëm del se janë shtuar shumë përgjatë kohës së pandemisë.

Në mënyrë që të jemi më afër qytetarëve tanë të cilët mund të përballen me dhunën në familje dhe jo vetëm është e nevojshme ngritja e Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje, i cili tashmë është funksional në disa komuna, pjesë e këtij mekanizmi Koordinues duhet të jenë Zyrtarët për Barazi Gjinore, Policia e Kosovës, Gjyqtarët, Qendra për Punë Sociale, Mbrojtësit e Viktimave, Drejtoria Komunale e Arsimit, Zyra e Punësimit, Organizata të Shoqërisë Civile dhe akterë të tjerë relevantë.

Veç këtij mekanizmi janë edhe disa forma të tjera me të cilat pushteti lokal mund të angazhohet në mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës mbi baza gjinore, DKA-ja duhet të punoj në vetëdijesimin e gjeneratave të reja lidhur me dhunën në familje dhe pasojat e saj, por edhe të ndihmoj në identifikimin e rasteve të dhunës duke komunikuar vazhdimisht me fëmijët dhe prindërit e tyre nëpërmjet mekanizmave që posedojnë shkollat, Drejtoria e Shëndetësisë duhet të gjej forma për të përgatitur edhe më shumë stafin e QPS-së dhe QMF-ve lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pasi nga hulumtimet e bëra nga shoqëria civile këto institucione në nivel vendi nuk qëndrojnë mirë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Për vajzat e gratë është jashtëzakonisht e rëndësishme pavarësia ekonomike, statistikën në këtë drejtim lënë shumë për të dëshiruar, pak gra janë të përfshira në tregun e punës, pak gra drejtojnë biznese e edhe më pak gra trashëgojnë pasuri. Transporti publik vazhdon të jetë sfidë për qytetin tonë, duke qenë se linjat e fundit të autobusëve për fshatrat e Drenasit janë

në ora 18:15 e ajo nga kryeqyteti për në Drenas në ora 20:15, ky është shqetësim edhe për vajzat studente që mund të kenë ligjërata pasdite por edhe për vajzat dhe gratë që punojnë në orarin e pasdites, e ky shqetësim rritet edhe më shumë në kohën e pushimeve vjetore të nxënësve kur transporti për fshatra është thuajse jo funksional, si komunë ne duhet të gjejmë mundësinë për të zgjatur orarin e qarkullimit të linjave nga kryeqyteti dhe sinkronizimin e këtyre linjave me autobusët lokalë edhe pas orës 18:00.

Një arsye pse shpesh gratë përjashtohen nga tregu i punës është edhe krijimi i familjes nga to, për shkak se vijnë nga shoqëri patriarkale e kemi të mbjellur idenë se vetëm gratë duhet të kujdesen për fëmijët dhe pavarësisht vetëdijesimit të burrave kjo barrë vazhdon të rëndoje akoma tek gratë, që një grua me fëmijë të punoj ajo ka nevojë për një vend që do të përkujdeset për fëmijën e saj, si komunë duke pasur vetëm një çerdhe publike ne nuk qëndrojmë aspak mirë në këtë aspekt, veç dy çerdheve të reja që do të ndërtohen ne do të duhej të shqyrtonim edhe mundësinë për ndërtimin e çerdheve me bazë në komunitet por po ashtu të shohim mundësinë që nënat vetushqyese që punojnë dhe ato që kanë më shumë se dy fëmijë të kenë ndihmë nga komuna në formë të subvencionimit të çerdheve për fëmijët e tyre. Veç veprimeve me transport dhe çerdhe komuna duhet ti mbështes edhe vajzat sportiste, të gjithë jemi dëshmitarë se klubet e djemve të qytetit kanë marrë më shumë fonde nga komuna sesa ato të vajzave. Pavarësisht gjithë sfidave të përmendura më lart ne kemi shënuar progres në luftën për barazi gjinore, sot një grua qëndron në krye të shtetit tonë, shumë gra janë të përfshira në qeverisjen qendrore e atë lokale të shtetit, niveli i përfaqësimit gjinor në Kuvendin e Republikës tonë krahasohet me atë evropian, çdo ditë dëgjojmë për storie suksesi të vajzave e grave brenda dhe jashtë vendit tonë, por akoma mbetet shumë punë për tu bërë, e këtë mund ta bëjmë kur ne angazhohemi për secilën grua, të fshatit e qytetit tonë, pavarësisht statusit social, përgatitjes profesionale e pozicionit në shoqëri, jo të gjitha vajzat e gratë kanë zë e ne që kemi, e kemi për obligim të jemi edhe zëri i tyre, ne jemi më të forta vetëm kur e ngrisim njëra-tjetrën, askush nuk i kupton e nuk mund ti ndihmoj gratë më shumë se ato njëra-tjetrën por për të arrit barazi në shoqëri këtë rrugëtim duhet ta bëjmë bashkë me djemtë e burrat që synojnë një shoqëri ku vlerat e barazisë janë fundament i shoqërisë.

Milaim Hajdari- Kryesues- hapi diskutimin për piken e dytë të rendit të ditës:

2. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400-49872, të datës 30.09.2021

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi e hodhi në votim, propozim vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400-49872, të datës 30.09.2021, prezent gjatë votimit ishin 17 anëtar dhe votuan me: **16 vota (Për), 1 votë (Kundër), 0 vota (Abstenim).** Të tjerët u larguan nga seanca.

Pasi nuk pati diskutime të tjera mbledhja përfundoi në ora 11:30 min .

Me gjerësisht, mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 08.03.2022 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalën YouTube.


Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT



Zyra e Kryetarit
Nr. 01-400/0110966
Drenas, me 10.03.2022

Në vështrim të nenit 58 paragrafi 1, nën(h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Kryetari i Komunës së Drenasit propozon:

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2. Pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën _____ 2022 të miratoj këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për mallrat dhe shërbimet në buxhetin e drejtoratit për shërbimet publike dhe emergjente për projektet: Mirëmbajta e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike dhe Rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara

Neni 1

Me këtë Propozim –Vendim, miratohet transferi i mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë ekonomike për Mallrat dhe Shërbimet në programin buxhetor të Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Neni 2

Transferi i këtyre mjeteve bëhet nga kategoria ekonomike rezerva i buxhetit të planifikuar i DSHPE-së dhe miratuar nga Kuvendi i komunës, në kategorinë për mallrat dhe Shërbimet në projektet :

- Kodi i projektit : 21/611180-1421555-89017/0451, Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike **40,000.00 €**

- Kodi i projektit : 10/611180-2036062-49289/0451, Rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara në komunën e Drenasit
32,100.00 €

Totali:

.....
72,100.00€

Shuma e mjeteve për transfer e përmendur në nenin 2 të këtij Propozim-Vendimi do të shpenzohen në kategorinë ekonomike për Mallrat dhe Shërbimet , konkretisht në projektet e lartshënuara.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet e Financa dhe Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë



KRYETARI I KOMUNËS

[Signature]

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L – 048 ,Komuna e Drenasit obligohet të miratoj Vendimin për transferin e mjeteve për shpenzime nga kategoria ekonomike Rezerva, të cilat mjete me herët kanë qenë të planifikuara dhe të miratuara nga Kuvendi i komunës së Drenasit, për këto dy projekte kapitale për të cilat janë të nënshkruara kontratat, niveli Qeveritar i ka destinuar si kategori ekonomike rezerva, shumën e kryer projekteve në vlerën prej 72,100.00€, andaj transferi i këtyre mjeteve është i domosdoshëm për realizimin e këtyre projekteve.



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



Nr 01-052/01-10503 Dt. 07.03.2022

Për : Vlorë Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës

Nga : Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës



-RAPORTI I DYTË PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020

Çështja	E gjetura	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pazbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
Çështja A1-	Vonesa në deponimin e parash së gatshme në llogarinë bankare. Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat përcakton që paratë e grumbulluara nga Organizatat Buxhetore (OB) nga arkëtimet për shërbime në lartësi deri 10€, duhet në fund të ditës të depozitohen në llogarinë bankare. Në tri raste kemi evidentuar se paratë e arkëtuara në zyrat e gjendjes civile, administratë si dhe participimi në QKMF, nuk ishin depozituar me kohë në arkë, rrjedhimisht në bankë. Vonesat ishin nga dy ditë deri afërsisht një muaj, ndonëse vlerat monetare nuk ishin materiale. Përkatesisht: Të hyrat e arkëtuara për certifikata në zyrën e gjendjes civile në Arllat nga data 04.08.2020-31.08.2020 në vlerë 238€; në zyrën e gjendjes civile në Komoran nga data 25.08.2020-01.09.2020 në vlerë 164€; dhe në administratë nga data 31.08.2020-01.09.2020, në vlerë 237€, të gjitha në vlerë totale 639€ ishin deponuar në bankë me datë 02.09.2020. Të hyrat e arkëtuara për taksa për regjistrimin e automjeteve në administratë nga data 16.12.2020-17.12.2020 në vlerë 890€ ishin deponuar në bankë me datë 18.12.2020. Të hyrat e arkëtuara nga participimi në	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që paratë e gatshme të grumbulluara të dorëzohen me kohë në arkë dhe të depozitohen në bankë në harmoni me kërkesat e rregullës financiare për të hyrat	Tani më jemi duke i zbatuar rekomandimet e ZKA-së për deponimin e parash së gatshme në llogarin bankare sipas dispozitave ligjore në fuqi.	I zbatuar	Largësia e zyreve të gjendjes civile nga qendra komunale.

	shëndetësi nga data 06.10.2020-12.10.2020, në vlerë 1,519€ ishin deponuar në bankë me datë 12.10.2020. Kjo ka ndodhur si shkak i kontrolleve të brendshme jo efikase përkatësisht rrethanave vështirësuese në organizimin e stafit.				
Çështja A2-	Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të objekteve brenda territorit të Komunës. Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Komuna në vitin 2020 nuk ka arritur të plotësoj kriterin e kryerjes së veprimtarive inspektuese, ngase nga totali 12,213 i objekteve të regjistruara janë verifikuar 1,510 objekte apo rreth 12%. Kjo ka ndodhur si shkak i dobësive në organizimin e veprimtarive inspektuese, por edhe si rezultat i ndikimit të pandemisë dhe vështirësive tjera në organizimin e stafit.	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizimit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjorë të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga inspektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.	Në këtë rast ka lëvizje pozitive nga që e kemi mobilizuar tërë stafin e ZKTP-së, duke punuar me orar të zgjatur dhe njëkohësisht, tani më, është shpallur edhe konkursi për pranim të zyrtarëve adekuat për verifikimin e 20% të pronave në teren.	I zbatuar.	-II-
Çështja A3-	Dobësi në përmbushjen e kriterit të dosjes së tenderit lidhur me vërtetimin tatimor. Në dosje të tenderit dhe te njoftimi për kontratë, te kushtet për pjesëmarrje respektivisht te kërkesat e përshtatshmërisë, ishte përcaktuar si kriter "Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve. Ky vërtetim	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin e vlerësimit dhe përgjdhjes së tenderëve konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë	Pas rekomandimit nga auditoret, ZP, ka ndërmarrë veprime të nevojshme duke e paraqitur rastin në organe përgjegjëse, njëkohësisht për çdo operator fitues, ZP-ja vërtetimet në fjalë bënë	Plotësisht i zbatuar.	Volumi i madhë i punëve dhe mungesa e stafit, bëjnë të mundur të ketë lëshime të pabullneshme.

	duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilit synohet dhënia e kontratës". Te aktiviteti i prokurimit përkatësisht te kontrata "Inventarizimi i shkollave - faza e dytë", në vlerë 115,800€, te njëri nga grupi i operatorëve ekonomik, kemi identifikuar se vërtetimi tatimor ishte prezantuar me validitet të skaduar përtej afatit 90 ditor nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, dhe jo në përputhje me datën në sistemin elektronik të Administratës Tatimore të Kosovës. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin vlerësimit të tenderëve dhe dhënies së kontratës konform kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë			verifikimin e tyre përmes platformave elektronike.	
Çështja A4-	Mos respektimi i kriterëve gjatë vlerësimit të aplikacioneve. Sipas thirrjes publike të dt. 07.05.2020 për ofrimin e mbështetjes financiare për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ishte kërkuar kriteri për aplikim se "Pas nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale". Nga testimi i thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e sportit dhe kulturës, kemi identifikuar dhjetë (10) raste në të cilat përfituesit janë shpërblyer me kontratë për	Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të siguroj që, fillimisht, kriteret e vendosura në thirrjet publike hartohen konform kërkesave dhe udhëzuesve të nivelit qëndror dhe atij lokal që rregullojnë këtë fushë. Pastaj, të siguroj se subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e	Në vitin 2021, kjo çështje është e rregulluar.	I zbatuar.	-//-

	mbështetje financiare, përderisa në dosjet e përfituesve mungonte dëshmia se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale. Kjo gjendje ishte si pasojë e asaj se kriteri lidhur me provat për veprat penale ishte kërkuar pas nënshkrimit të kontratës derisa kjo ishte dashur të kerkohej para nënshkrimit të kontratës me përfituesit e subvencioneve	vendosura në thirrje publike.			
Çështja B1-	Mungesa e projektit ekzekutues. Neni 20.10 i RrUOPP kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten. Ne kemi identifikuar se në 24 kontrata pune, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte te ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve. Komuna kishte kontratë me një operator për hartimin e projekteve, mirëpo nuk ishte e kënaqur me cilësinë e projekteve të marra nga operatori, prandaj procedurat e prokurimit janë zhvilluar vetëm me paramasë dhe parallogari.	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos inicohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.	Operatri Ekonomik i kontraktuar për hartim te projekteve ka qenë jo profesional në punën e kontraktuar, shumë projekte te hartuar ka pasur defekte teknike ne projektet e të cilat gjatë realizimit ka pasur pengesa.	I pa zbatuar	-//-
Çështja B2-	Ndryshime në pozicionet e kontratave pa aprovimin paraprak të ZKA-së. Neni 61.21 Rr.UOPP specifikon se	Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para	Gjitha punet e realizuara në keto kontratat te cilat kanë	I zbatuar	Veshtersi për arsye se në teren ka punime te

	"Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer", dhe neni 61.22 thotë se "ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit", ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet "vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtarit Kryesor Administrativ" Gjatë testimit të pagesave ne kemi identifikuar katër (4) kontrata në të cilat kishte pasur devijime apo ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur apo zvogëluar sasinë e kontraktuar (me reflektim financiar prej 2€ deri në 3,033€), por pa rritur çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga zyra e prokurimit dhe nga ZKA ashtu siç kërkohet me nenet 61.22 dhe 61.23 të RrUOPP. Përkatesisht kontratat: • "Rregullimi i rrjetit të kanalizimeve në fshatrat Baice, Krajkovë dhe Damanak" ndryshimet e sasive janë identifikuar në tetë (8) pozicione; • Lot 1 "Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat Shtuticë dhe Verbovc", në 20 pozicione; • "Kanalizimi i ujerave të zeza në Komunën e Drenasit - faza e dytë" në nëntë (9) pozicione; dhe • "LOT II Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat Abri dhe Terdec" në 15 pozicione. Nevoja për ndryshime kishte ardhur për shkak të mungesës së projekteve ekzekutive dhe kërkesave të banorëve lokal për ndryshime specifike sipas nevojave të tyre. Duhet theksuar se dukuria e mangësive të tilla në menaxhimin e kontratave ishte	ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA.	kaluar gjatësit e kontraktuar duke mos tejkaluar vlerën e kontratave. Gjate viti 2021 janë ndërmarr masa në këtë drejtim duke marrë aprovimin e ZKA-s në projektet të cilat kanë pasur ndryshime.	paplanifikuar dhe punimet kryhen vetëm me paramas pa projekt zbatues.
--	---	--	---	--

Çështja B3-	paraqitur edhe në raportin e auditimit të vitit paraprak.	Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive si dhe procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare. Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare thotë se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare. Ne kemi evidentuar 14 pagesa të shpenzimeve kapitale dhe jo kapitale prej 489,283€ të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare (prej tyre 11 pagesa me vlerë 376,842€ nuk janë regjistruar në SIMFK dhe tre (3) pagesa prej 112,441€ në epasuria). Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare ishte kryer me vonesë, rrejdhimisht nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare para datës së përgatitjes së PFV-ve. Si rezultat, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare sipas	Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Zyrtari i Pasurisë është pranuar dhe gjatë vitit fiskal 2021 ka bërë azhurnimin e e regjistrit të pasurive kapitale, njëherit Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare është zbatuar plotësisht.	I zbatuar	Sfidë në menaxhimin e E-pasurisë është edhe mungesa e mirëmbajtjes dhe menaxhimit me këtë system I cili menaxhohet nga ASHi-ja.
---------------------------	--	---	---	--	------------------	--

Çështja B4-	kërkesave të Rregullores 02/2013. Sipas zyrtarëve komunal, kjo gjendje ishte për shkak të volumit të madh të punëve në fund të vitit, vonesave në procesin e inventarizimit si dhe mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive, ndonëse kjo çështje është trajtuar edhe në auditimin paraprak.	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin me kohë të llogarive të arkëtueshme, duke mos përfshijtur edhe masat juridike.	Hapi 1. Si ZTPR, kemi marrë të gjitha masat për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme për vitin 2021. Kemi kërkuar nga drejtoratet-zyrë komunale që të zbatojnë dispozitat ligjore, duke kërkuar vertetimin e pagesës së tatimit në pronë; pastaj kemi dërguar letër-kujtesat dhe vërejtjet e fundit të tatimpaguesve me borxhe mbi 1000.00€. Hapi 2. Lidhur me arkëtimin borxheve të vjetra të Taksës Komunale: -Janë duke u zbatuar marrëveshjet e lidhura paraprakisht në mesë të komunës dhe OE, për	Pjesërisht i zbatuar	Pandemia Covid-19, është sfida kryesore.
---------------------------	--	--	--	-----------------------------	---

			kryerjen e pagesave. Për këtë periudhë të vitit fiskal 2021, llogaritë e arkëtushme janë zvogluar dukshëm. Sa i përket borxheve të bizneseve tjera arkëtushme të taksave në biznes, dhe është duke përfunduar barjen e të dhënave nga kartelet e programit të vjetër në program të ri, i cili program ofron saktësi dhe korrektesë.		
Çështja B5-	Mangësi në listën e detyrimeve kontingjente. Sipas Rregullores së MF-Nr.01/2017 Për Pasqyrat Financiare të Organizatave Buxhetore, neni 18 përcakton se: Organizatat Buxhetore në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente. Kemi evidentuar tre (3) raste në shumë 6,607€ të cilat në listën e detyrimeve kontingjente nuk kishin të përcaktuar vlerën financiare, rrjedhimisht vlera e detyrimeve kontingjente e shpalosur në PFV ishte e nënvlerësuar për këtë vlerë. Po ashtu, në kuadër të detyrimeve kontingjente, ishin përfshirë edhe detyrimet prej 78,674€ për të cilat ekzistonte një vendim i formës së prerë nga ana e gjykatave lidhur me to dhe se pritej vetëm ekzekutimi i	Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike me Avokaturën Shtetërore për të siguruar shpalosje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontingjente.	Për implementimin e rekomandimit në fjalë, Zyra Ligjore e Komunës (e kompletuar që nga nëntori i vitit 2021) është në kontakt të vazhdueshëm dhe ka bashkpunuar me DKA, DSHMS si dhe DBF-në më saktësisht me Zyrat Kryesore Financiar në kuadër të Komunës, nga kjo ky rekomandim është plotësisht i implementuar.	I zbatuar	--

	pagesave nga Thesari. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë mes zyrtarëve ligjor të komunës dhe Avokaturës Shtetërore (si përfaqësues i komunës) dhe sektorëve tjerë brenda komunës për evidentimin dhe regjistrimin e saktë të detyrimeve kontigjente.				
Çështja B6-	Mos kompletimi i NJAB. Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë. NJAB në Komunën e Gllogocit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar. Kjo gjendje ishte për shkak mungesës së buxhetit të ndarë për plotësimin e numrit minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore.	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NJAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NJAB.	Me Planin Strategjik të NJAB-së për vitin 2022-2024, nga NJAB-i është kërkuar shtimi i numrit të auditorëve në vitin 2022 dhe është planifikuar me planin e personelit për vitin 2022.	Pjesërisht i zbatuar	Mos aprovimi i vendeve të lira të punës nga MAP.



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT



Zyra e Kryetarit

Nr. 01-400/01-12102

Drenas, me 17.03.2022

Në vështrim të nenit 58 paragrafi 1, nën(h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Kryetari i Komunës së Drenasit propozon:

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2.Pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën _____ 2022 të miratoj këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorin për mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtoratit për Infrastrukturë Publike:

Mbikqyrja e projekteve kapitale ne KK Drenas ,

Hartimi i projekteve zbatuse për nevoja të Komunes dhe

Hartimi i projektit të fizibiliteti për nxemje qendrore.

Neni 1

Me këtë Propozim –Vendim, miratohet transferi i mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë ekonomike për mallra dhe shërbime në programin buxhetor të Drejtoratit për Infrastruktur Publike.

Neni 2

Transferi i këtyre mjeteve bëhet nga kategoria ekonomike rezerva i buxhetit të planifikuar i drejtorisë së Infrastruktures Publike dhe miratuar nga Kuvendi i komunës, në kategorinë për mallra dhe shërbime në projektet :

- Kodi i projektit : 10/611180-1934563-48685/0451, Mbikqyrja e projekteve kapitale

.....

40,000.00 €

- Kodi i projektit : 10/611180-1934567-48688/0451, Hartimi i projekteve për nevoja të komunën

.....

58,246.00 €

- Kodi i projektit : 10/611180-2035998-49249/0451, Hartimi i projektit të fizibilitetit për nxemje qendrore

10,000.00 €

Totali:

.....

108,246.00€

Shuma e mjeteve për transfer e përmendur në nenin 2 të këtij Propozim-Vendimi do të shpenzohen në kategorinë ekonomike për mallra dhe shërbime , konkretisht në projektet e lartshënuara.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Infrastruktur Publike.

KRYETARI I KOMUNËS


Ramiz Lladrovci



Arsyetim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L – 048 ,Komuna e Drenasit obligohet të miratoj Vendimin për transferin e mjeteve për shpenzime nga kategoria ekonomike Rezerva, të cilat mjete me herët kanë qenë të planifikuara dhe të miratuara nga Kuvendi i komunës së Drenasit, për këto dy projekte kapitale për të cilat janë të nënshkruara kontratat, niveli Qeveritar i ka destinuar si kategori ekonomike rezerva, shumën e kryer projekteve në vlerën prej 108,246.00€, andaj transferi i këtyre mjeteve është i domosdoshëm për realizimin e këtyre projekteve.